

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6651  
E martë, 12 korrik 2022  
çmimi 0.40

## Në Prizren mbahet marsh paqeje për viktimat e gjenocidit në Srebrenicë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KURTI TAKON LAJÇAKUN NË GREQI, I THOTË SË KOSOVA ËSHTË 'PËRHERË E GATSHME PËR DIALOG PARIMOR'

FAQE 4-5



Gjatë punimeve të Symi Symposium që po mbahet në Greqi, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar për mbarëvajtjen e procesit të deritanishëm të dialogut dhe për hapat e ardhshëm në këtë proces. Kurti i ka thënë Lajçakut se Kosova është 'përherë e gatshme për dialog parimor'

cilin ka diskutuar për mbarëvajtjen e procesit të deritanishëm të dialogut dhe për hapat e ardhshëm në këtë proces. Kurti i ka thënë Lajçakut se Kosova është 'përherë e gatshme për dialog parimor'

## AKTUALE



27 VJET PAS GJENOCIDIT,  
VARROSEN PESËDHJETË VIKTIMA  
TË SREBRENICËS F. 2

KOSOVA MIRËPRET GAZETARE TË  
TJERA NGA UKRAINA F. 3

MBI 900 ANKESA PËR  
POLICËT E KOSOVËS  
DHE MBI 118 TË SUSPENDUAR F. 6



## EKONOMI



RREZIK NGA MUNGESA  
E GRURIT NË KOSOVË F. 8

## SPORT



UNIVERSITARET HUMBIN  
NDESHJEN E PARË F. 11



RRETH  
32 % E TË  
TESTUARVE  
PËR  
KORONAVIRUS  
NË KOSOVË,  
POZITIVË

FAQE 3



120 PERSONA HELMOHEN  
NË HAN TË ELEZIT,  
SHKAKTAR DYSHOHET  
TË JETË UJI I PIJSHËM F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kryeministrja franceze i mbijeton mocionit të mosbesimit

PARIS, 11 KORRIK - Kryeministrja e Francës, Elisabeth Borne, të hënën i mbijetoi mocionit të parë të mosbesimit në Parlament, mocion i sponsorizuar nga opozita e krahut të majtë.

Mocioni - për të cilin kërkoheshin 289 vota për të kaluar - u mbështet nga 146 deputetë në Parlamentin Kombëtar prej 57 deputetësh. Votimi pasoi një debat prej tre orësh.

Partia Franca e papërkulur (LFI) e ngriti mocionin kundër Borne, e cila udhëheq qeverinë e pakicës. Por, kryeministrja nuk ishte në rrezik pasi partitë e tjera opozitare deklaruan para

votimit se nuk do ta mbështetnin mocionin.

Gjatë debatit, kryeministrja franceze akuzoi partinë LFI se po humbet kohën parlamentare për tema më të rëndësishme. "Zonja dhe zotërinj, sot ne do të mund të punonim për të mirë e popullit francez, por në vend të kësaj ne po debatojmë për mocionin e mosbesimit, që bazohet në synimet e mia të pretenduara dhe që po pengon punën e Parlamentit, njëherësh edhe dëshirën e popullit francez", tha Borne para votimit.

Borne u emërua në pozitën e kryeministres në maj nga presidenti Emmanuel

Macron, vetëm një muaj para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, në të cilat, partia centriste që është në pushtet, humbi shumicën. "Ne nuk do të pranojmë asnjëherë që dikush ta mbajë pushtetin e këtij shteti me legjitimitetin e vetëm që është emëruar nga presidenti", tha ligjvënësi i LFI-së, Alexis Corbiere.

"Ky është momenti i së vërtetës", tha liderja e grupit parlamentar e LFI-së, Mathilde Panot.

Borne, 61 vjeçe, e ka bërë të qartë se planifikon që të varet nga votat e partive opozitare për të kaluar ligjet që do të sjellë në Parlament, teksa



partia Republikane e krahut të djathtë po shihet si subjekti kyç për të ardhmen e saj. Mbështetja e 62 deputetëve të

republikanëve do të ishte e mjaftueshme që qeveria të mund të kalonte të gjitha ligjet në Parlamentin francez.

## Erdogani i kërkon Putinin të lejojë dërgimin e ndihmave në Siri



ANKARA, 11 KORRIK - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, të hënën, më 11 korrik, i bëri thirrje homologut të tij rus, Vladimir Putin, që ta zgjeronte autorizimin për kalimin e kufirit për dërgesat humanitare brenda Sirisë. Kjo kërkesë e Erdoganit vjen teksa diplomatët po tentojnë që të gjejnë zgjidhje që do të mund ta shmangte veton ruse dhe do ta mundësonte vazhdimin e dërgimit të ndihmës humanitare në Siri. "Erdogani theksoi se ai i kushton rëndësi të madhe

zgjerimit të mekanizimit për kalimin e kufirit në Siri", tha zyra e tij përmes një deklarate, pas bisedës telefonike midis liderëve.

Kjo bisedë vjen pasi të dielën ka skaduar mekanizmi që lejon dërgimin e ndihmave humanitare në Sirinë e shkatërruar nga lufta.

Kufiri midis Turqisë dhe Sirisë, përkatësisht pikëkalimi kufitar i Baba al-Hava, është rruga e vetme që Kombet e Bashkuara të dërgojnë ndihmë për civilët, pa kaluar përmes territoreve të kontrolluara nga forcat e qeverisë siriane.

Rusia, aleate e regjimit në Siri, ka përdorur veton në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për t'i kundërshtuar propozimet perëndimore që ky pikëkalim kufitar të mbahet i hapur edhe për një vit.

Mosmarrëveshjet për këtë çështje vijnë në kohën kur tensionet diplomatike janë të larta për shkak të pushtimit rus të Ukrainës.

Në të kaluarën Këshilli i Sigurimit kishte zgatur mekanizimin e kalimit të kufirit dhe ka ende shpresë se një votim për këtë gjë mund të ndodhë gjatë kësaj jave.

## Varrosen pesëdhjetë viktimat të Srebrenicës, 27 vjet pas gjenocidit

POTOÇAR, 11 KORRIK - Eshtrat e 50 viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, të identifikuara së voni, u varrosën të hënën në Qendrën Përkujtimore Potoçari - aty ku ndodhen varret e mbi 6 670 viktimave të tjera.

Kjo ceremoni u bë me rastin e 27-vjetorit të masakrës së Srebrenicës, në të cilën forcat serbe vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë gjatë luftës së viteve '90.

Masakra është cilësuar si mizoria më e rëndë në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e ka njohur si gjenocid.

Në Potoçari, ceremonitë përkujtimore të masakrës i

ndoqën mijëra veta.

Hamdija Fejziq, kryetar i Komitetit Organizativ për Përkujtimin e Përvjetorit të Gjenocidit dhe nënkryetar i komunës së Srebrenicës, tha se ishte me fat që i mbijetoi gjenocidit.

Fejziq tha se ngjarja e tmerrshme nuk duhet të bëhet kurrë "vetëm një fusnotë në historinë e njerëzimit".

Ai u bëri thirrje zyrtarëve në Bosnjë-Hercegovinë që të ndërmarrin hapa konkretë për ta bërë Srebrenicën "një qytet jete, e jo vdekjeje". "Në Srebrenicë, fëmijët e lindur pas gjenocidit, rriten dhe ata janë shpresa jonë", tha Fejziq.

Michael Murphy, ambasador i ShBA-së në Sarajevë, tha se



vrastet në Srebrenicë janë "një ngjarje e errët në histori, jo vetëm për [Bosnjë-Hercegovinën], por për gjithë

njerëzimin". Më 11 korrik të vitit 1995 forcat serbe të Bosnjës kanë hyrë në Srebrenicë - zonën e shpallur

të sigurt nga Kombet e Bashkuara.

Në ditët që kanë pasuar, ato kanë vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë, ndërsa trupat e tyre i kanë hedhur në gropa në pyjet përreth.

Vrasjet kanë ndodhur për pak ditë, por procesi i gjetjes së trupave ka marrë vite dhe identifikimi dhe varrimin i eshtrave vazhdojnë ende.

Deri më tani 47 persona janë dënuar me më shumë se 700 vjet burgim për rolet e tyre në gjenocid.

Ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, është dënuar me burgim të përjetshëm, ashtu si edhe ish-udhëheqësi ushtarak në Bosnjë, Ratko Mlladiq.

## Kosova mirëpret gazetaret e tjera të Ukrainës

PRISHTINË, 11 KORRIK - Të hënën në Kosovë kanë mbërritur gazetaret e radhës ukrainase, Maryna Zhyvotkova dhe Viktoria Kaidash, si pjesë e programit "Journalists in Residence - Kosovo". Gazetaret janë mirëpritur në aeroport nga zyrtarja ligjore e ECPMF-së, Flutura Kusari,

drejtoresha ekzekutive e AGK-së, Getoarbë Mulliqi-Boja, përfaqësues të MPB-së dhe Policisë së Kosovës. Deri më tani si pjesë e programit "Journalists in Residence - Kosovo", që financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, janë strehuar katër kolegë ukrainas. Në kuadër të këtij

programi gazetarët që janë detyruar të ikin nga Ukraina përfitojnë pagë mujore, pagesën e qirasë dhe sigurim shëndetësor. European Centre for Press and Media Freedom ECPMF dhe AGK janë duke bërë përgatitje që në ditët në vijim të presin gazetarë të tjerë nga Ukraina.



## Rreth 32 % e të testuarve për koronavirus në Kosovë, pozitivë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 KORRIK - Edhe 110 raste të reja me koronavirus u raportuan të hënën në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, në bazë të 344 testeve të kryera në 24 orët paraprake, gati 32 për qind e të testuarve kanë dalë pozitivë. Aktualisht raste aktive me koronavirus në Kosovë janë 2 116. Në 24 orët e kaluara Ministria e Shëndetësisë tha se janë

shëruar 163 pacientë, ndërsa viktima nuk ka pasur. Numri i rasteve me koronavirus në Kosovë ka nisur të rritet në gjysmën e dytë të qershorit. Muajt e pranverës kanë qenë kryesisht të qetë sa iu përket infektiveve, ka pasur ditë me zero raste. Shkalla e infeksionit është në rritje edhe në vende të tjera të Ballkanit dhe më gjerë. Besohet se në qarkullim janë disa nënvariente të variantit Omicron të koronavirusit, që

përhapen më shpejt, por shkaktojnë më pak simptoma. Në Kosovë më pak se gjysma e popullatës së përgjithshme, përkatësisht mbi 823 mijë veta, kanë marrë dy doza të vaksinës kundër koronavirusit. Me dozën e tretë janë vaksinuar mbi 103 mijë qytetarë. Javën e kaluar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës ka miratuar dozën e katërt të vaksinës për personat mbi 60 vjeç, që e kanë marrë dozën e tretë së paku katër muaj më herët.

## Abazoviqi kërkon falje për deklaratën për gjenocidin në Srebrenicë

PODGORICË, 11 KORRIK - Kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazoviq, tha se deklarata e tij në 27-vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë ishte "e paqartë" dhe u kërkoj falje familjarëve të viktimave. "U kërkoj falje nënave të Srebrenicës për mendimin e shprehur në mënyrë të paqartë. Dihet se çdo vepër varet nga qëllimi i saj. Qëllimi im është paqja. Gjenocidi i kryer kundër boshnjakëve në Srebrenicë të mos përsëritet ndaj askujt", shkroi ai në "Telegram". Kjo kërkimfalje vjen pasi familjarët e viktimave të gjenocidit, shoqatat dhe përfaqësuesit e partive politike

në Mal të Zi, thanë se Abazoviqi relativizoi gjenocidin në Srebrenicë. "Gjenocidi nuk u krye kundër boshnjakëve, por kundër njerëzve, dhe nuk u krye nga ushtritë, por nga politikanët, politika e së keqes, politika e vdekjes dhe politika e mashtrimit", tha Abazoviqi në përkujtim të 27-vjetorit të gjenocidit kundër boshnjakëve në Srebrenicë. Pas kësaj deklarate, familjarët e viktimave dhe shoqatat i kërkuar Abazoviqit që të kërkojë falje sepse definicioni i gjenocidit thotë se ai përbën "synimin për të shkatërruar plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor apo



fetar".

Shoqata "Nënat e Srebrenicës" tha se Abazoviqi duhet t'u kërkojë falje të gjithë viktimave të gjenocidit në Srebrenicë. "Fëmijët tanë u vranë vetëm

sepse ishin boshnjakë, ata u vranë nga një ushtri e organizuar. Në Potoçari nuk ka vend për relativizim të krimit", tha kjo shoqatë përmes "Twitter"-it.

Qendra Memoriale e Srebrenicës e falënderoi Abazoviqin por, gjithashtu, kërkoi nga ai t'i lexojë vendimet e gjykatave ndërkombëtare. "Megjithatë, ndaj boshnjakëve u krye gjenocid - sepse motivi i vrasjeve nuk ishte 'vrasja e njerëzve', por vrasja dhe shkatërrimi i një populli. Këtë jua mësojnë vendimet e gjykatave ndërkombëtare. Lexojini ato", shkroi kjo qendër në "Twitter". Reagime për deklaratën e Abazoviqit ka pasur edhe nga Mali i Zi, përkatësisht nga Partia Socialdemokrate, subjekt që është pjesë e qeverisë së pakicës së Abazoviqit.

## "Forbes": Shqipëria drejt legalizimit të kanabisit

TIRANË, 11 KORRIK - Nisma e qeverisë shqiptare për ta legalizuar kanabisin për qëllime mjekësore ka tërhequr vëmendjen edhe jashtë kufijve. Në një artikull të gjatë të revistës së njohur amerikane "Forbes" thuhet se edhe Shqipëria pritet t'u shtohet vendeve që e kanë hedhur tashmë këtë hap. Në artikull theksohet që në nisje se kultivimi, prodhimi dhe tregtia do të jenë të destinuar vetëm për eksport. "Forbes" citon edhe projektligjin e hedhur për konsultim publik. sipas të cilit,



do të lejohet prodhimi i kanabisit mjekësor dhe kanabisit industrial për deri në 150 hektarë tokë duke filluar nga viti 2023. Do të jetë Këshilli i Ministrave që do të japë licenca për prodhimin e kanabisit për 15 vjet me të drejtë rinovimi. Bizneset e kanabisit që duan të operojnë në sektorët e kanabisit mjekësor dhe industrial në Shqipëri duhet të tregojnë se kanë kapital mbi 86 000 dollarë, të punësojnë të paktën 15 persona dhe të paguajnë një tarifë prej 1.5 % të xhiros vjetore

të kompanisë. Në shkrimin e "Forbes"-it bëhet një përshkrim i gjatë për përballjen e qeverisë shqiptare me fenomenin e kultivimit të kanabisit, akuzat e opozitës për lidhje të eksponentëve të qeverisë me trafikun e drogës dhe raportet ndërkombëtare për këtë fenomen. "Forbes" citon edhe këshillimin kombëtar ku mbi 308 mijë qytetarë votuan pro legalizimit të kanabisit mjekësor, 148 mijë ishin kundër dhe 51 mijë nuk dhanë asnjë mendim për këtë çështje.



## Në Prizren mbahet marsh paqeje për viktimat e gjenocidit në Srebrenicë

**Faton DËRMAKU**

Prizren, 11 korrik - Në qytetin e Prizrenit, të hënë, më 11 korrik, u mbajt një marsh i paqes në 27-vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë. Pas këtij marshi, si simbol i paqes, u lëshuan pëllumba të bardhë.

Organizatori i marshit, Edis Jonuzi, tha se 11 korriku i vitit 1995, kur forcat serbe të Bosnjës vranë mbi 8 000 burra dhe djem boshnjakë në Srebrenicë, nuk duhet të harrohet kurrë. “Sot nuk jemi në Potoçari me nënat e Srebrenicës, por ato janë në zemrat dhe mendjet tona. Prandaj, nga këtu, ne boshnjakët, shqiptarët, turqit, romët dhe të tjerët, nderojmë viktimat”, ka thënë Jonuzi.

Në marshin e paqes në Prizren, përveç pjesëtarëve të komunitetit boshnjak, morën pjesë edhe përfaqësues të komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë, përfshirë edhe kryetarin e komunës, Shaqir Totaj.

Kjo është hera e pestë që në Prizren mbahet marsh paqeje në nderim të viktimave të gjenocidit.

Rasim Demiri, përfaqësues i koalicionit Vakrat, theksoi se “gjenocidi në Srebrenicë nuk ndodhi, por ishte planifikuar nga agresori serb”.

Në marshin e paqes në Prizren

morën pjesë edhe boshnjakë nga Novi-Pazari, qytet në Serbi. Po ashtu, i pranishëm ishte edhe ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar. “Ne po vazhdojmë të bëjmë përpjekje për të krijuar paqe dhe stabilitet në gjithë Ballkanin dhe më gjerë në mënyrë që masakrat e së kaluarës të mos përsëriten”, tha Sakar.

Para mbajtjes së marshit, përmes rrjeteve sociale, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Serbia paturpshëm e mohon gjenocidin në Srebrenicë, ndërkaq presidentja Vjosa Osmani tha se “të gjithë duhet të bashkohemi kundër përpjekjeve për të madhëruar ose mohuar këto mizori të tmerrshme”.

Më 7 korrik 2021 Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Srebrenicën, që dënon gjenocidin e regjimit serb ndaj pjesëtarëve të kombit boshnjak. Kjo rezolutë dënon ashpër mohimin e gjenocidit dhe 11 korrikun e shpall Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë.

Në vitin 2007 Gjykata Ndërkombëtare në Hagë tha se në Srebrenicë ishte kryer gjenocid.

Më 8 qershor të vitit 2021 gjyqtarët e gjykatës së OKB-së konfirmuan dënimin me burgim të përgjithshëm ndaj ish-komandantit të Ushtrisë së

Republikës Sërpska, Ratko Mlladiq. Ai u shpall fajtor për gjenocid në Srebrenicë, persekutim, krime kundër njerëzimit, shfarosje dhe krime të tjera lufte në Bosnjë-Hercegovinë, të kryera ndërmjet viteve 1992 dhe 1995.

Në fund të korrikut të vitit 2021, ish-përfaqësuesi i Lartë në Bosnjë e Hercegovinë, Valentin Inzko, bëri ndryshime në Kodin Penal të këtij shteti, duke ndaluar mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të luftës dhe

madhërimit të kriminelëve të luftës.

### Kosova: Serbia paturpshëm mohon gjenocidin në Srebrenicë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Serbia paturpshëm mohon gjenocidin në Srebrenicë, vendin ku forcat serbe të Bosnjës vranë mbi 8 000 burra dhe djem muslimanë gjatë luftës së viteve '90.

Më 11 korrik u bënë 27 vjet nga kjo masakër, e cilësuar si më e rënda në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. “Kur organet që do të duhej të dilnin e të kërkonin falje me përlulje, dalin paturpësisht mohojnë ekzistencën e gjenocidit...”, shkroi Kurti në “Facebook”.

Autoritetet në Serbi, por edhe udhëheqësit e serbëve të Bosnjës, refuzojnë të pranojnë se në Srebrenicë ka ndodhur gjenocid dhe masakrën e quajnë



# Kurti takon Lajçakun në Greqi, i thotë se Kosova është 'përherë e gatshme për dialog parimor'



Gjatë punimeve të Symi Symposium që po mbahet në Greqi, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka diskutuar për mbarëvajtjen e procesit të deritanishëm të dialogut dhe hapat e ardhshëm në këtë proces. Kurti i ka thënë Lajçakut se Kosova është 'përherë e gatshme për dialog parimor'

**ATHINË, 11 KORRIK (ER)** - Gjatë punimeve të Symi Symposium që po mbahet në Greqi, kryeministri Albin Kurti takoi përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Siç njoftohet, mbarëvajtja e procesit të deritanishëm të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, si dhe

hapat e ardhshëm në këtë proces, ishin tema kryesore të takimit.

Kurti theksoi sërish që Qeveria e Republikës së Kosovës është përherë e gatshme për dialog parimor, të balancuar e konstruktiv. "Kryeministri Kurti theksoi sërish që Qeveria e Republikës së Kosovës është përherë e gatshme për dialog parimor, të balancuar e

konstruktiv. Ai ritheksoi se nga ky dialog duhet të përfitojnë qytetarët e të dyja vendeve, nëpërmjet një marrëveshjeje të qëndrueshme e të zbatueshme, që në qendër ka njohjen reciproke. Për këtë, kemi edhe Rezolutën e Parlamentit Evropian, të miratuar pak ditë më parë, ku bëhet thirrje që Kosova dhe Serbia të arrijnë marrëveshje bazuar në njohje reciproke", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Më herët përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, pati deklaruar se në marrëdhëniet Kosovë - Serbi është krijuar një "situatë e re" që i ka ndryshuar "planet dhe temat" e vizitës së tij në

Kosovë dhe Serbi, pasi Qeveria e Kosovës, më 29 qershor, miratoi vendimin për mundësitë e reregjistrimit të veturave me targat e lëshuara nga autoritetet e Serbisë me targa RKS (Republika e Kosovës).

Qeveria e Kosovës, po ashtu, miratoi udhëzimin për kalimin e pikave kufitare me dokumente personale, sipas të cilit, të gjithë personat që kanë dokumente të lëshuara nga autoritetet e Serbisë, me të hyrë në territorin e Kosovës, duhet të pajisen me një certifikatë që i zëvendëson ato dokumente.

Qytetarët e Kosovës me vite marrin një certifikatë që i zëvendëson dokumentet e tyre personale kur hyjnë në

territorin e Serbisë.

Beogradi zyrtar reagoi ashpër ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës, duke thënë se kryeministri Albin Kurti "po i kërcënon me luftë serbët në Kosovë".

Lajçaku pati theksuar për gazetarët në Beograd se "kjo situatë duhet të zgjidhet". "Nuk guxojmë të lejojmë që të ndodhë ndonjë krizë", ishte shprehur ai.

Përpara se të udhëtonte në Beograd, më 29 qershor, Lajçaku ka qëndruar në Kosovë nga data 27 qershor, ku ka thënë se është duke punuar për përgatitjen e një takimi midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

"krim i madh", edhe përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e ka njohur masakrën si gjenocid.

Vitin e kaluar, ish-përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar për Bosnjën, Valentin Inzko, e ka shpallur të jashtëligjshëm mohimin e gjenocidit dhe të krimeve të luftës, duke e bërë një akt të tillë të dënueshëm me burg.

Masakra e Srebrenicës ka ndodhur pesë muaj para përfundimit të luftës në Bosnjë, më 1995. Deri më tani 47 persona janë dënuar me më shumë se 700 vjet burgim për rolet e tyre në masakër.

Ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, është dënuar me burgim të përjetshëm, ashtu si edhe ish-udhëheqësi ushtarak në Bosnjë, Ratko Mlladiq.

"Dëmi i shkaktuar nga gjenocidi nuk mund të riparohet, por ai mund të njihet duke u pranuar", shkroi Kurti.

Edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shkruar për 27-vjetorin e masakrës së Srebrenicës, ku mbi 8 mijë djem, burra e pleq u ekzekutuan në harkun e pesë ditëve, në aktin më të tmerrshëm të gjenocidit që nga Lufta e Dytë Botërore.

"Në këtë projeksion tragjik, të planifikuar e çnjerëzor, shumë nëna u lanë pa fëmijë, motra pa vëllezër, vajza pa baballarë - e një regjion i tërë pa burra. Kriminelët serbë, të udhëhequr nga kasapi Ratko Mladiq, nuk kishin kursyer as fëmijët e gratë", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Krasniqi ka theksuar se i njëjti mentalitet sistematik, i orkestruar e gjakatar serb, i ngritur mbi vdekjet e përndjekjet, me karakter të pastër gjenocidal e duke mos kursyer askënd, u realizua edhe në Kosovë më 1998-99.

"Fatkeqësisht, qindra kriminelë serbë që sollën shumë vdekje e shumë dhimbje në Ballkan, vazhdojnë të enden të lirë, pa marrë asnjëherë dënimin e merituar. Asnjëherë nuk do të harrojmë, asnjëherë të mos përsëritet!", ka shkruar Krasniqi. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka kujtuar 27-vjetorin e masakrës së Srebrenicës. Ai në "Twitter" ka shkruar se gjenocidi i Srebrenicës është shenja më e errët e historisë moderne e cila ndodhi në zemër të Evropës. "8 372 djem dhe burra u ekzekutuan nga forcat

nacionaliste serbe. Ekzekutuesit kanë një trashëgimi të fortë në Serbi sot, mohuesit e gjenocidit", ka shkruar Abdixhiku.

Për 27-vjetorin e masakrës së Srebrenicës ka shkruar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se bashkëndien me popullin e Bosnjës dhe e kupton dhembjen e tij. "Gjenocidi në Srebrenicë dhe vrasjet e tjera masive në Ballkan, të kryera nga regjimi i Millosheviqit, mbeten njolla të pashlyera në ndërgjegjen e njerëzimit, derisa nuk vendoset drejtësia", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## BIK-u njofton se janë therur mbi 12 mijë kurbanë

Prishtinë, 11 korrik - Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka njoftuar se ka përfunduar afati i pranimeve për pagesë të kurbanëve për këtë vit.

BIK-u përmes një shkrimi në "Facebook" ka treguar se këtë vit janë tubuar 12 174 kurbanë. "Bashkësia Islame e Kosovës njofton të gjithë besimtarët se

ka përfunduar afati i pranimeve për pagesë për therjen e kurbanëve në këtë institucion. Këtë vit, në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, janë tubuar mbi 12 174 kurbanë, për të cilët në ditët në vijim do të publikohen listat me emrat e të gjithë atyre që kanë therur

kurbanë në Bashkësinë Islame të Kosovës", ka njoftuar BIK. Bashkësia Islame e Kosovës ka falënderuar të gjithë besimtarët që ia besuan amanetin e therjes së kurbanit, duke lutur Zotin e Madhëruar që t'ua pranojë këtë ibadet dhe t'i shpërblejë me mirësitë e tij.



## Rreth 120 persona helmohen në Han të Elezit, shkaktar dyshohet të jetë uji i pijshëm

HANI I ELEZIT, 11 KORRIK - Rreth 120 persona janë paraqitur si të helmuar për të kërkuar ndihmë mjekësore në spitalin e komunës të Hanit të Elezit. Mjeku kujdestar Ardit Gola ka thënë për "Telegrafin" se rastet kanë filluar të paraqiten në spital nga ora 08:00 e së dielës dhe kanë vazhduar edhe gjatë ditës së hënë.

Sipas Golës, pacientët janë paraqitur në spital për të kërkuar ndihmë mjekësore pasi kishin vjellje, diarre dhe temperaturë. "Rreth 120 pacientë janë paraqitur për të kërkuar ndihmë mjekësore në spitalin e Hanit të Elezit gjatë ditës së iele, prej orës 08:00 deri në ora 12:00 të mesditës kishite fluks të fëmijëve që u paraqitën, kurse gjatë ditës u shtua fluksi i pacientëve të rritur. Simptomat e tyre ishin vjellje, diarre dhe temperaturë", tha Gola.

Ai ka shtuar se dyshimet janë që

këta persona kanë mundur të helmohen nga uji i ujës-jellësit të kontaminuar në komunën e Kaçanikut, pasi edhe në këtë komunë që nga e hëna e javës së kaluar rreth 300 qytetarë kishin kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).

Kryetari i komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, kishte thënë se disa qytetarë tash e disa ditë janë me simptoma të helmimit: diarre dhe të vjella.

Ilazi ka shtuar se mostrat e ujit të dyshuar për këtë helmim i kishin dërguar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe rezultatet kimike kanë dalë mirë, ndërkaq për analizat bakterologjike ende nuk kanë dalë rezultatet.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se mostrat e ujit të marra nga analizat bakteriologjike kanë treguar se nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijshëm.



## Mbi 900 ankesa për policët e Kosovës dhe mbi 118 të suspenduar



PRISHTINË, 11 KORRIK - Mbi 900 ankesa kanë dorëzuar qytetarët në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ky institucion gjatë këtij viti ka rekomanduar suspendimin e mbi 100 policëve, ndërkaq mbi 90 janë arrestuar. "Edhe këtë vit ka qenë numër relativisht i lartë, prej 1 janarit deri sot kemi pranuar mbi 900 ankesa, të cilat janë trajtuar dhe po trajtohen në departamentet përkatëse në IPK. Janë ankesa për sjellje të ndryshme të policisë, duke filluar prej keqtrajtimit gjatë ushtrimit të

detyrës zyrtare, për keqpërdorim, për marrje të ryshfetit në disa raste, për sjellje të pahijshme, për pakënaqësi në shqiptimin e gjobave në kundërvajtje", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i IPK-së, Kushtrim Hodaj.

Inspektorati Policor gjatë këtyre gjashtë muajve ka zhvilluar edhe operacionin e gjerë të koduar me emrin "Pika 1" dhe "Pika 2", ku mbi 70 pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë arrestuar dhe suspenduar. "Këtë vit kemi pasur numrin më të madh të rekomandimeve për

suspendim dhe të arrestimeve. Për shkak edhe të dy-tri rasteve që i kemi zhvilluar në luftën kundër korrupsionit, rastet që lidhen me policët e korruptuar në kufi në tri pika kufitare. Apo operacionet e njohura (pika një, pika dy), ku 76 punonjës të policisë janë arrestuar dhe suspenduar vetëm në këto dy raste. Numri i të suspenduarve në tërësi gjatë këtyre shtatë muajve kalon 117 apo 118 zyrtarë, dhe mbi 90 zyrtarë janë të arrestuar", ka thënë Hodaj.

## Së shpejti hapet konkursi për specializime

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë po planifikon që në shtator ta hapë konkursin për specializime. Këtë e ka bërë me dije për "KosovaPress", ministri Rifat Latifi, i cili tha se po synojnë që këto konkurse t'i bëjnë të përvitshme.

I pari i shëndetësisë ka thënë se numri i personave të pranuar për shkollim specialistik do të jetë i

arsyeshëm. "Konkursi do të hapet shumë shpejt, në shtator do të fillojnë specializimet e reja. Kjo do të ketë më pas ristrukturim marramendës sepse nuk mundën tre veta të ulen në një karrige, në një tavolinë e t'i zgjedhin të gjithë specialistët për të gjitha fushat. Ne do të fillojmë që për çdo vit të kemi specializime prej anestezionist, kardiokirurg të traumës të emergjencës e të

tjera. Nuk do të jetë 1 000. Do të jetë numër i arsyeshëm. Secili prej këtyre specializantëve të rinj do ta kalojë një kohë jashtë vendit", ka thënë Latifi.

Nevojën për specializime e ka shprehur edhe drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, i cili ka theksuar se i kanë identifikuar ku ka nevojë për më shumë specializime.



# Rrezik nga mungesa e grurit në Kosovë



**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Fermerët në Kosovë parashikojnë që nga fushata e korrje-shirjeve të grurit të sigurohen rreth 50 për qind e kërkesave të popullatës për ushqim. Për shkak të kushteve të pafavorshme klimatike dhe shtrenjtimit të çmimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, ata nuk janë në gjendje të garantojnë sasi dhe cilësi të duhur. Fermerët paralajmërojnë edhe vështirësi në furnizime nga importi për shkak të vazhdimit të luftës në Ukrainë si dhe bllokimit të eksporteve nga Ukraina dhe Rusia. Si Rusia, ashtu edhe Ukraina, janë ndër eksportueset më të mëdha të drithërave në botë dhe lufta mes tyre ka shkaktuar çrregullime në tregje.

Procesi i korrjes së grurit në Kosovë ka filluar në fund të muajit qershor. Isuf Cikaqi, drejtor në Departamentin për Politika Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, tha se, në bazë të të dhënave preliminare, sasia e prodhimit të grurit do të jetë brenda mesatares nga 3 500 - 4 500 kilogramë për hektar. Ai tregon se pritet të korren rreth 70 mijë hektarë sipërfaqe të mbjellë me këtë kulturë. “Edhe sivjet rendimenti do të jetë brenda kësaj mesatare, por është ende herët të flasim pa përfunduar procesi i korrjes”, thekson ai. Por, Pal Gjuraj nga Shoqata e Bujqve Prodhues të Grurit të

Kosovës konsideron se kjo sipërfaqe është e pamjaftueshme për nevojat e popullatës së përgjithshme. “Nuk pritet ndonjë rendiment, po flas për ditët e para të fillimit të korrjes. Pritet që për një hektar tokë rendimenti të arrijë 3 500 kilogramë, ndërkaq vitin e kaluar kjo ishte mbi 4 200 kilogramë”, thotë ai, duke shtuar se me këtë sasi të rendimentit do të sigurohet rreth 50 për qind e kërkesave të popullatës.

Sipas të dhënave zyrtare, në Kosovë nevojat për këtë produkt për kokë banori janë 204 kilogramë, që i bie se në Kosovë duhet të harxhohen 410 000 tonë grurë.

Në vitin 2020 Kosova ka siguruar 341 mijë tonë grurë nga 80 mijë hektarë sipërfaqe të mbjella me këtë kulturë. Të dhënat për vitin e kaluar mungojnë.

## Kasumi: Nëse vazhdon shtrenjtimi, do të zvogëlohen sipërfaqet me grurë

Fermeri Xhafer Kasumi nga komuna e Vushtrrisë sivjet ka kultivuar 24 hektarë tokë me grurë, njëmbëdhjetë hektarë më pak se vitin paraprak. Për shkak të rritjes së çmimit të plehut artificial dhe derivateve të naftës, vjeshtën e kaluar ai thotë se e ka zvogëluar sipërfaqen e tokës së mbjellë me grurë. Por, çmimet e këtyre produkteve kanë vazhduar të rriten

edhe gjatë këtij viti. Kasumi thotë se do ta zvogëlojë sipërfaqen e tokës së mbjellë me grurë.

Gruri duhet të plehërohet domosdo dy herë. Gjatë këtij viti 100 kilogramë pleh artificial kushtojnë 100 euro krahasuar me vitin e kaluar kur kanë kushtuar 32 euro.

Për një hektar tokë të kultivuar nevojiten deri në 300 kilogramë pleh. “Nuk di si do t’ia bëj. Mbi 6 000 euro më ka kushtuar vetëm plehërimi. Deri më tani kam korrur një pjesë të grurit dhe kur të përfundojë krejt, do ta llogaris a ia vlen të mbjell sivjet”, shprehet ai.

## Rritet edhe çmimi i grurit

Shtrenjtimi i plehut artificial dhe naftës ka bërë që edhe çmimi i grurit në treg të jetë më i lartë. Pal Gjuraj tregon se çmimi për një kilogram grurë kushton 30 centë edhe kjo vlerë, sipas tij, nuk është e leverdishme për fermerët. Vitin e kaluar çmimi për një kilogram grurë ka kushtuar 19 centë. “Ne i bëjmë ftesë qeverisë që të ndërmarrë hapa sa më të shpejtë, duke pasur parasysh që është sezon korrjesh jo vetëm te ne (Kosovë), por edhe në rajon, që të nisë të grumbullojë rezerva të grurit, përndryshe do të kemi vështirësi të jashtëzakonshme, sepse lufta ruse në Ukrainë do të ndikojë edhe në tregun e Kosovës”, thotë Gjuraj.

Imer Rusinovci, profesor në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, vlerëson se Kosova edhe sivjet do të varet nga importi, pasi në bazë të sasisë dhe cilësisë së grurit, ai llogarit se gjysma e nevojës të kërkesave të qytetarëve për këtë produkt nuk do të përmbushen.

Pushtimi rus i Ukrainës, sipas Rusinovcit, do ta shtrenjojë dhe do të vështirësojë edhe më tepër furnizimin me këtë produkt. “Unë besoj se nga muaji shtator, përkatësisht tetor, ky çmim do të jetë dyfish më i lartë. Pra, është vit më i vështirë në raport me vitet e kaluara, sfidat janë shumë të mëdha. Dhe, nga janari mund të ballafaqohemi, mos të themi me pasiguri ushqimore, por sigurisht me çmime enorme të grurit. Dhe nga gruri më pas shtrenjtohen edhe produktet e tjera ushqimore”, thekson Rusinovci.

Rusia dhe Ukraina eksportojnë pothuajse një të tretën e grurit dhe elbit në botë. Por, që nga nisja e pushtimit rus miliona tonë grurë dhe drithëra të tjera janë bllokuar prej muajsh në portet e Ukrainës, duke shkaktuar shqetësime mbi krizën dhe rritjen e çmimeve në të gjithë botën.

Prodhimi botëror i grurit, orizit dhe drithërave të tjera pritet të arrijë në 2.78 miliardë tonë më 2022, 16 milionë tonë më pak se vitin e kaluar.

Kjo është hera e parë në katër vjet që

ka rënë prodhimi i këtyre produkteve, tha Organizata e OKB-së për Ushqim dhe Agrikulturë.

Çmimet e grurit u rritën për 45 për qind në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, thuhet në indeksin e çmimeve të Organizatës për Ushqim dhe Agrikulturë.

Kosova nuk është shumë e varur nga importi i grurit nga Ukraina dhe Rusia, por vendet nga importohet ky produkt në Kosovë mund të kenë siguruar në këto shtete, thonë përfaqësues të shoqatës së bujqve dhe mullisëve.

Kosova sasinë më të madhe të grurit e importon nga shtetet e rajonit, përkatësisht nga Serbia. Për gjashtë muajt e këtij viti, sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, vendi ka importuar 45 mijë tonë grurë, gjatë vitit 2021, 115 mijë tonë lloje të ndryshme të grurit dhe miellit dhe në vitin 2020, rreth 160 mijë tonë.

Serbia është shteti nga i cili Kosova importon sasinë më të madhe të grurit dhe miellit, pasuar nga Hungaria, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina.

Për ta ulur sasinë e importit të produkteve bujqësore dhe rritjen e rendimenteve Qeveria e Kosovës më 9 mars ka ndarë 50 milionë euro për subvencionimin e sektorit të bujqësisë. Vetëm për subvencionimin e grurit janë ndarë 474 euro për hektar, përfshirë këtu shpenzimet e plehut dhe të naftës.

# Miliarderët mund ta armatosin Ukrainën



Nga Elisabeth BRAW

I dashur Jeff Bezos, e di që këto janë kohëra të trazura për ju dhe 2667 anëtarët e tjerë të klubit të miliarderëve të botës. Sipas Forbes, dikur ishit 2755 veta, por turbullirat aktuale kanë hequr nga lista 87 prej jush, dhe e kanë reduktuar me 400 miliardë dollarë pasurinë tuaj kolektive prej 12.7 trilion dollarësh.

Pastaj, ju dhe kolegët tuaj miliarderë dolët jashtëzakonisht mirë gjatë 2 viteve të para të pandemisë së Covid-19. Ju dhe 9 burrat e tjerë që jeni njerëzit më të pasur në botë, e dyfishuat pasurinë tuaj dhe klubi i miliarderëve fitonte një tjetër anëtarë të ri çdo 26 orë. Dhe ju në veçanti zoti Bezos, keni disa probleme logjistike shumë të bezdisshme.

Diçka ironike, duke pasur parasysh faktin që ju e keni bërë pasurinë tuaj prej 171 miliardë dollarësh pikërisht në biznesin e logjistikës. Jahti me kosto 500 milionë dollarë që po ndërtoni aktualisht në Holandë është siç raporton "Financial Times", aq i gjatë sa nuk do të futet dot nën urën Koningshaven të Roterdamit, pasi të ketë dalë nga kantieri.

Ndoshta ndërtuesi holandez i anijeve, harroi se anijet me direkë 70 metra të lartë nuk i përshtaten parametrave të shumicës së urave. Ose ndoshta të gjithë supozuan se autoritetet e Roterdamit do të binin dakord me kërkesën që ndërtuesi i anijeve po bën tani, për të çmontuar përkohësisht urën 95-vjeçare De Hef, në mënyrë që të lundrojë jahti juaj.

Zyrtarët e qytetit, mund të bien dakord ta çmontojnë urën disa herë në vit për anije të tilla si e

jotja, për një tarifë modeste prej 100.000 eurosh. Por kjo nuk është një ide shumë e pëlqyeshme për vendasit. "A është ndërtuar ky qytet, vetëm për t'u siguruar miliarderëve të gjitha komoditetet?" - pyeti për "Times" Pol Van de Lar, kreu i departamentit të historisë në Universitetin Erasmus të Roterdamit.

Por problemet tuaja janë më të mëdha sesa kaq. Në botë shumë gjëra nuk po ecin si duhet, dhe kjo mund të pakësojë pasurinë tuaj prej 171 miliardësh, dhe ndoshta t'i largojë nga klubi i pasanikëve disa nga kolegët tuaj miliarderë. Unë e di që ju jeni tashmë të vetëdijshëm për emergjencën e ndryshimeve klimatike.

Por edhe më e menjëhershme është kriza e afërt ekonomike. Pushtimi rus i Ukrainës po sjell rritjen e çmimeve ushqimore, dhe çmimet e energjisë po rriten për të njëjtën arsye. Në qershor, bursat kryesore ranë me 2 për qind ose më shumë. Ekonomistët, politikë-bërësit dhe industrialistët po paralajmërojnë një recesion global.

Kreu ekzekutiv i "Morgan Stanley", Xhejms Gorman, ka llogaritur që shanset që Shtetet e Bashkuara të bien në recesion janë 50 me 50. Krizat klimatike dhe paqëndrueshmëria globale do ta dëmtojnë pasurinë tuaj. Në kushtet e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, një arsye kryesore e kësaj kthese me pasoja katastrofike, gjithçka që duhet të bëjë bota për të shmangur një rënie ekonomike serioze, është t'i ndihmojë ukrainasit t'i mposhtin pushtuesit e tyre rusë.

Problemi nuk është mungesa e dëshirës së ukrainasve për ta bërë këtë por mungesa e

armëve. Këtu mund të ndërhyri ju dhe 2667 miliarderët e tjerë. Shumë qeveri perëndimore po bëjnë tashmë gjithçka që po munden për ta ndihmuar Ukrainën. Qeveria amerikane ka dhënë deri më sot më shumë se 25 miliardë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën.

Qeveria britanike rreth 2.5 miliardë dollarë, ndërsa Gjermania dhe Polonia më shumë se 1 miliardë dollarë secila. Dhe kjo ndihmë vetëm në armë. Qeveritë perëndimore – midis tyre edhe Australia – kanë premtuar dhe ofruar çdo lloj ndihme tjetër për Ukrainën. Rreth 6.5 milionë ukrainas janë zhvendosur në Poloni dhe vende të tjera fqinje.

E gjitha kjo po i ngarkon shumë qeveritë perëndimore, sidomos ato evropiane. Dhe mos harroni: këto qeveri duhet të mbështesin edhe qytetarët e tyre, të cilët tani po përballen me çmimet shumë të larta të ushqimeve dhe energjisë. Për të mos përmendur krizën e emigracionit, që mund të shkaktojë kriza globale e ushqimit.

Pasi siç e dini mirë, kjo krizë do të godasë vendet afrikane dhe ato të Lindjes së Mesme edhe më fort se ato evropiane. Qeveritë perëndimore mund të përpiqen ta zgjidhin krizën e tyre financiare duke rritur taksat për më të pasurit. Një hap, për të cilin unë e di që shumica në grupin tuaj të shquar nuk do ta mirëprisnin.

Por nëse Ukraina nuk do të marrë shumë shpejt armë të reja, lufta do të vazhdojë për një kohë shumë të gjatë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, tha në fillim të këtij muaji se ajo mund të zgjasë me vite. Unë e di që as grupi juaj i famshëm nuk do ta mirëpriste

një të ardhme të tillë, pasi është e sigurt se ajo do ta përkeqësojë më tej rënien ekonomike globale.

Prandaj zoti Bezos dhe zotërinjtë e tjerë të klubit të miliarderëve, ja cili është propozimi im i drejtpërdrejtë: Bëhuni bashkë – 2, 3, 4 ose ndoshta më shumë – dhe blijuni ukrainasve armët që u nevojiten. Edhe me një pjesë vogël të pasurisë suaj të kombinuar prej 12.7 trilion dollarësh, ju do të shpenzoni pa mundim më shumë se sa Rusia në këtë luftë.

Përpara se të protestoni, duke thënë se civilët e zakonshëm nuk mund të blejnë armë për forcat e armatosura të vendeve, unë po ju them se kjo ka ndodhur tashmë. Deri më sot qytetarët e thjeshtë çekë, kanë mbledhur më shumë se 53 milionë dollarë për armë për Ukrainën.

Muajin e kaluar, lituanëzët mbledhën më shumë se 5 milionë dollarë e nevojshëm për blerjen e një droni ushtarak, të cilin po e përdorin tani ukrainasit. Këta janë vetëm çekë dhe lituanianë të zakonshëm. Imagjinoni se çfarë mund të arrini ju me pasurinë tuaj, lidhjet dhe fuqinë tuaj për t'i bindur kolegët tuaj të industrive të mëdha.

Është e vërtetë, që prodhuesit e armëve në botë janë për momentin jashtëzakonisht të zënë. Siç e përmenda edhe më lart, bota ka shumë probleme sot. Por ukrainasit kanë nevojë për të gjitha llojet e armatimit, duke filluar nga municionet. Ashtu si gjatë muajve më të këqij të pandemisë, kur fabrikat ndaluan prodhimin e çdo gjëje dhe kaluan në prodhimin e pajisjeve mbrojtëse, tani mund të kalojnë tek prodhimi i

municione.

Imagjinoni një ditë kur mund të jeni në gjendje t'u thoni nipërve tuaj se vendosët të mos blini një jaht 500 milionë dollarësh, dhe e shpenzuar një pjesë të vogël të pasurisë suaj për të ndihmuar në arritjen e paqes në botë. Nipërit tuaj do të ishin krenarë për ju. Ju nuk do të jeni në gjendje ta bëni vetë këtë gjë.

Ashtu si me të gjithë tregtinë e armëve, qeveritë duhet të miratojnë shitjen dhe dërgimin e armëve në Ukrainë. Por nëse çekët dhe lituanëzët e zakonshëm mund të marrin miratimin nga qeveria, po kështu mundeni edhe ju. Disa nga anëtarët e grupit tuaj vijnë nga shumë kombe të ndryshme, disa prej tyre shumë larg nga Ukraina. Dhe disa prej tyre mund të duan të vazhdojnë të bëjnë biznes me Rusinë. Por kjo nuk është një ide e mirë. Prosperiteti juaj varet nga mirë-funksionimi i botës. Nëse Ukraina nuk arrin ta mposht Rusinë, në radhë do të jenë vendet e tjera evropiane. Nëse kjo ndodh, rendi botëror nga i cili varet pasuria juaj, do të shërmoqet.

Dhe më lejoni t'ju them një të vërtetë tjetër të pakëndshme: Shumica e njerëzve në mbarë botën nuk ju pëlqejnë shumë ju dhe të ngjashmit tuaj. Ata ju konsiderojnë si parazitë, njerëz që vazhdimisht minimizojnë barrën e tyre tatimore, duke na e lënë barrën kryesore në të tjerëve.

Ndaj shpenzimi i një pjese të pasurisë suaj për armë për Ukrainën do të ndihmonte në përmirësimin e imazhit tuaj. Ajo do ta ndihmonte Ukrainën të mposhte pushtuesit rusë, dhe kështu të vendoste në një gjendje të barabartë ekonominë globale. / "Foreign Policy" – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Universitaret humbin ndeshjen e parë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ekipi i hendbollistëve të Universitetit të Prishtinës e ka humbur ndeshjen e parë në Kupën Botërore Universitare që të hënën nisi në Prishtinë. Në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet, hendbollistet tona u takuan me hendbollistet e Universitetit "Castilla - La Mancha" nga Spanja. Spanjollët kanë fituar me rezultat të lartë, 32:23. Dallimi është bërë në pjesën e dytë, pasi pjesa e parë përfundoi 15:12 në të mirë të ekipit spanjoll. Në pjesën e dytë lojtaret e universitetit spanjoll

me lojë të shpejtë, e kryesisht me kundërsulme, krijuan epërsi bindëse që e mbajtën deri në fund. Ndërkohë në lojën e ekipit të Universitetit të Prishtinës kanë funksionuar pak gjëra, përkundër angazhimit. Ka pasur telashe në sulm, e sidomos në mbrojtje. Elisa Mulaj ishte më efikasja me 7 gola. 5 i realizoi Yllka Shatri, ndërsa 4 i kishte Melisa Mulaj. 3 gola i shënoi Alma Nivokazi. Të martën prej orës 16:00 ekipi i Universitetit të Prishtinës e ka një tjetër ndeshje të vështirë. Takohet me "University North" të Kroacisë.



## Kosova mëson orarin e Evropianit



PRISHTINË, 11 KORRIK - Kampionati Evropian fillon nesër në Prizren. Ngjarja më e madhe sportive në qytetin prizrenas do të bashkojë tetë kombëtare, në garë për trofeun e çmuar. 20 ndeshje për pesë ditë pritet të dhurojnë spektakël në palestrën "Sezai Surroi". Kosova është në grup me Shqipërinë, Maltën dhe San Marinon. Sfida hapëse është ndaj Maltës, të martën mbrëma, që është përballja e parë e dardanëve të rinj në këtë Evropian. Përkrahja nga tifozët është shumë e nevojshme për

basketbollistët e rinj të Kosovës. Takimi i dytë do të jetë ndaj Shqipërisë të mërkurën dhe ndeshja e fundit në grupe ndaj San Marinos të enjten. Në grupin tjetër garojnë Gjibraltari, Armenia, Andorra dhe Moldova.


### ORARI

12 Korrik  
20:45 Kosova-Malta  
13 Korrik  
20:30 Kosova-Shqipëria  
14 Korrik  
20:30 Kosova-San Marino

## Muriqi mund të kalojë përfundimisht në Mallorca

ROMË, 11 KORRIK - Vedat Muriqi nuk ia doli të kalonte vizitat mjekësore dhe në këtë mënyrë dështoi kalimi i tij te Club Brugge, me Lazion që tashmë ka paralajmëruar se do të bëjë ankesë në FIFA ndaj klubit belg. Sulmuesi Kosovës është rikthyer te Lazio, skuadër që ka në zotërim kartonin e tij, teksa ditën e sotme ka kaluar me sukses vizitat mjekësore tek lacianët. Ndërkohë, mediet italiane shkruajnë se tashmë në skenë ka dalë përsëri pista Mallorca, skuadër që Muriqi

mbyllin gjysmën e dytë të zezonit në huazim. Ish-futbollisti i Fenerbahçes realizoi 5 gola dhe dhuroi 3 asistime në 16 ndeshje me klubin ishullor, të cilin e ndihmoi që të mos binte nga liga. Sipas "La Lazio Siamo Noi", Lazio mund ta shesë "Piratin" në klubin e La Ligas për 7-8 milionë euro pasi paraprakisht Mallorca ishte tërhequr nga blerja e kartonit të Muriqit, për të cilin Lazio deri tash i kërkonte së paku 10 milionë euro.



## Ten Hag: Ronaldo nuk do të largohet nga United

Manchester, 11 korrik - Erik Ten Hag ka dhënë konferencën e parë për shtyp në aventurën e re që ka nisur te Manchester United. Trajneri holandez nuk iu shmang çështjeve aktuale që

po "ziejnë" "Old Trafford". Ai foli për largimin e mundshëm të Cristiano Ronaldos dhe u tregua i kujdesshëm për Frenkie de Jong. "Cristiano Ronaldo nuk është në shitje, ai është në

planet tona, nuk është me ne për arsye personale. Ne po planifikojmë sezonin me Cristiano Ronaldon në skuadër, kjo është e gjitha. Kam folur me të para se të dilte kjo çështje, pata një

bisedë. Ai nuk më ka thënë se dëshiron të largohet. De Jong? Kurrë nuk flas për futbollistë që kanë kontratë me ekipe të tjera. Nuk do të përgjigjem kësaj pyetje", ka deklaruar Ten Hag.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “G&D company” SH.P.K. me pronar Milena Ivanoviq rr. “Mbreti Petri 1” c42 29, Mitrovicë Veriore ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811565722, Mitrovicë dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “G&D company” D.O.O. Milena Ivanoviq rr. “Mbreti Petri 1” c42 29, Mitrovicë Veriore, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811565722, Mitrovicë ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “G&D company” L.L.C. Milena Ivanoviq rr. “Mbreti Petri 1” c42 29, Mitrovicë Veriore, has come to the decision to quit its business: 811565722, Mitrovicë the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Denisi Park” SH.P.K. pronar Betim Berisha Kqiq i Madh Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 601513410 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Denisi Park” Betim Berisha Kqiq i Madh, Mitrovicë D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 601513410 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Denisi Park” L.L.C. pronar Betim Berisha Kqiq i Madh, Mitrovicë has come to the decision to quit its business: 601513410 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Bekim Sufaj nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. “Durak Ahmeti” Damjan KK Gjakovë nga kl. I-VIII.
- ▶ Andrias Ndue nga Smaqi i Gjakovëshpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. “At Gjergj Fishta” Bishtazhin KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçant me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

